VENDIM
Nr. 268, datë 27.10.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 14.2.2025, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'EB ENERGY' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2451/1 prot., datë 24.10.2025, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'EB Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw"',

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "EB Energy" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 14.2.2025, ka licencuar shoqërinë "EB Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 30-vjeçar.
- Në kuptim të sa përcaktuar në pikat 2 dhe 3, shoqëria duhet që të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda muajit shtator 2025, si dhe duhet të fillojë operimin/ ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 5.12.2025.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria "EB Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2451 prot., datë 12.9.2025, ka depozituar procesverbalin e nënshkruar midis shoqërisë zhvilluese "EB Energy" sh.p.k., subjektit ndërtues shoqëria "Kirac Green Energy" sh.p.k., si dhe mbikëqyrësit të punimeve "HTS" sh.p.k., mbi përfundimin e punimeve të "Ndërtimit të impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw dhe veprave ndihmëse" me vendndodhje në Topojë, Bashkia Fier.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me shqyrtimin e kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria "EB Energy" sh.p.k., mbi përfundimin e ndërtimit të impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, së bashku me procesverbalin përkatës të përfundimit të punimeve të datës 10 shtator 2025, vlerësohet se kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, është i përmbushur nga ana e shoqërisë dhe për rrjedhojë duhet shfuqizuar.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria "EB Energy" sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës.
- Gjithashtu, pika 5, e vendimit nr. 40/2025, përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

- "Në kuadër të plotësimit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi", vlerësohet të bëhet: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të plotësimit të pikës 3 të këtij vendimi.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, shfuqizohet.

2. Pika 5, e vendimit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, ndryshon dhe bëhet: "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kuadër të plotësimit të pikës 3 të këtij vendimi.".

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë "EB Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, "OSSH" sh.a., "FTL" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti